



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË- Dega nw Zubin Potok

Numri i lëndës: 2019:125807

Datë: 05.06.2024

Numri i dokumentit: 05785140

P.nr.114/2018

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – Dega në Zubin Potok - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, Gjyqtarja e vetme gjykuese Qëndresa Tahiri Islami, me bashkëpunëtoren profesionale Edita Koliqi, në lëndën penale ndaj të pandehurit: M.A, për shkak të veprës penale: Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 paragrafi 9 në lidhje me paragrafin 6 dhe paragrafin 1 të Kodit (Nr.04/L-082) Penal të Republikës së Kosovës (*tutje si: KPRK*), duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.1047/18, të datës 24.12.2018, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar me datë 16.05.2024, në mungesë të prokurores së shtetit Vyrtyte Gërvalla, të dëmtuarit Ivan Tanaskovic, si dhe të pandehurit M.A me avokatin mbrojtës, av.Uvejs Gashi, me datë 16.05.2024 shpalli publikisht, ndërsa me datë 05.06.2024, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

M.A, nga i ati, e ëma, i lindur me datë, në fshatin Bërnjak, Komuna e Zubin Potokut, me adresë të vendqëndrimit në Beograd në rrugën “.....”, ka të kryer shkollën e mesme, i pamartuar, pensionist, me numër personal të identifikimit, i nacionalitetit serb.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE:

Me datë 26.10.2015, rreth orës 13:47 në fshatin Bërnjak – fshati Dragaljice, Komuna e Zubin Potokut, ka shkaktuar rrezik për jetën e njerëzve dhe me veprimtarin e tij të rrezikshme ka shkaktuar vdekjen e një personi, në atë mënyrë që ka shkuar me të ndjerin B.T me ftesën e tij për t’i transportuar një sasi të caktuar dru zjarri nga liqeni i Gazivodës në shtëpinë e tij familjare, R.T dhe M.T shkuan me ta dhe ai ishte duke vozitur një kamion “Mercedes” portokalli, me targa

të regjistrimit i ngarkuar me dru zjarri ah, megjithëse ishte i vetëdijshëm se me një veprim të tillë mund të ndodhte një pasojë e ndaluar, por ai besonte lehtësisht se pasoja nuk do të ndodhte ose se do të ishte në gjendje ta parandalonte , gjë që ndodhi kur ata arritën pranë shtëpisë tani të ndjerit B.T, në këtë kamion me shofer ishin R.T dhe M.T, ndërsa i ndjeri B.T ishte në hapësirën e ngarkesave i ulur mbi pemë, kështu që kur A u përpoq ta kthente kamionin për shkak të kushteve të këqija të rrugës dhe natyrës së rrëshqitshme të sipërfaqes së rrugës , rrugë rurale të pakategorizuar, kamioni filloi të rrëshqasë, pas së cilës A u përpoq të ndalonte kamionin e tij, i cili ishte transportuar nga inercia dhe pesha e madhe e ngarkesës që mbante, doli nga rruga, pas së cilës ai u ndal papritur dhe nga pjesa e ngarkesës së automjetit, i dëmtuari B.T bie në tokë, të cilit i bien drunjtë e ngarkuar dhe pëson lëndime në formë të thyerjes të rruzave cervikale C6, C7 me dislokim, me pasoja të paralizës së ekstremiteteve të epërme dhe të poshtme, çrregullim në sistemin e frymarrjes dhe në sistemin e zemrës, lëndime këto të rënda fizike me pasoja të përhershme dhe si pasojë e këtyre i dëmtuari B.T vdes me datë 09.12.2015, në Spitalin e Mitrovicës, ku u kthye nga mjekimi nga Beogradi në IOHB “Banjica”.

-Me këto veprime ka kryer veprën penale: Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 par.9 në lidhje me par.6 dhe par.1 të KPRK-së.

Andaj, Gjykata, në bazë të nenit 1, 4, 7, 17, 23, 41, 42, 49, 50, 51, 52, 73, 75, 76 dhe 365 të KPRK-ës, dhe nenit 358, 364, 449, 462 të KPP-së, i:

S H Q I P T O N

- I.** DËNIM ME BURGIM të kushtëzuar në kohëzgjatje prej njëmbëdhjetë (11) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen vepër tjetër penale gjatë periudhës së verifikimit, në kohëzgjatje prej dy (2) viteve, nga plotfuqishmëria e këtij Aktgjykimi.
- II.** Obligohet i pandehuri, që t'i paguajë shpenzimet e procedurës gjyqësore dhe atë në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej njëzet (20) euro, po ashtu edhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumën njëzet (20) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.
- III.** Pala e dëmtuar Ivan Tanaskovic, udhëzohen në kontest të rregullt civil, lidhur me kërkesën pasurore - juridike.

ARSYETIM

Aktakuza

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.1047/18, të datës 24.12.2018, ndaj të pandehurit M.A, për shkak të veprës penale: Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 paragrafi 9 në lidhje me paragrafin 6 dhe paragrafin 1 të KPRK-së.

Rrjedha e procedurës

Gjykata, me datë 16.05.2024, ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar, në praninë e palëve, prokurorit të shtetit Vyrtyte Gërvalla, të dëmtuarit I.T, si dhe të pandehurit M.A me mbrojtësin e tij sipas detyrës zyrtare, av.Uvejs Gashi.

I pandehuri, gjatë seancës së shqyrtimit fillestar, pas njoftimit nga gjykata me të drejtat e tij në këtë fazë të procedurës penale dhe leximit të aktakuzës, ka pranuar fajësinë në tërësi për veprën penale sipas aktit akuzues, duke theksuar se rasti ka ndodhur nga pakujdesia.

Gjykata ka marrë mendimin e palëve mbi pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit.

Prokurorja e Shtetit Vyrtyte Gërvalla, propozoi gjykatës që të miratoj pranimin e fajësisë, pasi që pranimi i fajësisë është në përputhje me provat që gjenden në shkresat e lëndës, e po ashtu në përputhje me kushtet ligjore të parapara në dispozitat të KPP-së, lidhur me institutin e pranimit të fajësisë. Si rrethanë lehtësuese gjykata të ketë parasysh pranimin e fajësisë nga i pandehuri dhe keqardhjen e shfaqur, ndërsa sa i përket rrethanave rënduese është shprehur që gjykata sipas detyrës zyrtare të pajiset me certifikatë nga evidenca penale për të kaluarën e të pandehurit, e varësisht nga rezultatet, e që në rast se rezulton se i njëjti edhe më herët ka qenë kryerës i veprave penale ta merr si rrethanë rënduese, në të kundërtën të merret si rrethanë lehtësuese.

I dëmtuari I.T, propozoi që të pandehurit ti pranohet pranimi i fajësisë, ndërsa lidhur me rrethanat e matjes së dënimit, theksoi që si palë e dëmtuar nuk e ngarkojnë farë të pandehurin, pasi që rasti ka ndodhur nga pakujdesia dhe i njëjti çdo vit ia ka bartur drunjtë babit tim.

Mbrojtësi e të pandehurit M.A, av.Uvejs Gashi, lidhur me pranimin e fajësisë ka dhënë mendimin që të miratohet pranimi i fajësisë, pasi që pranimi i fajësisë ka ardhur pas këshillave me të si

mbrojtës, është bërë me vullnet të plotë dhe me vetëdije dhe është edhe në përputhje me aktakuzën e Prokurorisë. Ndërsa sa i përket rrethanave të matjes së dënimit, propozoi që të aplikohen dispozitat e zbutjes së dënimit, ashtu që gjykata të merr parasysh si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë, keqardhjen e shfaqur, ndihmën që ka ofruar i pandehuri tani të ndjerit, duke e ndihmuar të njëjtin, duke i qëndruar pranë edhe në spital në Beograd, pasojat e kësaj vepre penale që e kanë goditur rëndë kryerësin, faktin se vepra penale është kryer nga pakujdesia.

Gjetjet e Gjykatës

Gjykata ka shqyrtuar pranimin e fajësisë të cilin e ka deklaruar e pandehuri M.A, në mbështetje të nenit 242 të KPP-së, ka vlerësuar se janë përmbushur kushtet ligjore për miratimin e pranimit të fajësisë për të pandehurën. Gjykata gjen se pranimi i fajësisë nga i pandehuri mbështetet në tërësi në provat që përmban kjo akuzë, siç janë: Procesverbali i marrjes në pyetje për dëshmitarin I.T i datës 30.04.2018; Raporti fillestar i incidentit me numër të rastit 2015-SH-078 i datës 26.10.2015; Raporti policor i datës 26.10.2015; Shënimi zyrtar i datës 26.10.2015; Procesverbali mbi intervistimin e të pandehurit i datës 27.10.2015; Procesverbali i marrjes në pyetje për dëshmitarin R.T i datës 02.11.2015; Procesverbali i marrjes në pyetje për dëshmitarin M.T i datës 02.11.2015; Lista e gjërave të kthyerë e datës 29.10.2015; Raportet mjekësorë dhe certifikata e vdekjes në emër të ndjerit B.T; si dhe shkresat tjera të lëndës. Të gjitha këto prova janë bindëse dhe formojnë në tërësi elementet inkriminuese, e që në bazë të tyre dhe pranimit të fajësisë nga i pandehuri, përtej çdo dyshimi vërtetohet se i pandehuri ka kryer veprën penale: Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 par.9 në lidhje me par.6 dhe par.1 të KPRK-së.

Gjykata gjen se pranimi i fajësisë është bërë nga i pandehuri në mënyrë vullnetare, pasi që ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë. Gjykata ia kishte tërheq vërejtjen të pandehurit se pas pranimit të fajësisë nuk mundet të shfrytëzojnë të drejtën në ankesë, lidhur me bazën për gjendjen faktike, i njëjti është njoftuar se nëse e pranon fajësinë humb mundësinë e kundërshtimit të provave në aktakuzë dhe mundësinë për paraqitjen e provave tjera, si dhe për faktin se pranimi i fajësisë sipas ligjit është një rrethanë lehtësuese që me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata mund të shqiptoj një dënim më të butë. Gjykata gjithashtu ka vërtetuar se aktakuza në këtë rast nuk përmban asnjë shkelje ligjore e as ndonjë gabim faktik dhe nuk ka bazë për hedhjen e akuzës.

Gjykata bazuar në pranimin e fajësisë nga i pandehuri dhe mbi bazën e provave të cekura si më lartë, përtej çdo dyshimi ka vërtetuar se i pandehuri M.A është i përgjegjshëm dhe përgjegjës për

veprën penale për të cilën akuzohet: Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 par.9 në lidhje me par.6 dhe par.1 të KPRK-së.

Matja e llojit dhe lartësisë së dënimit:

Gjykata, lidhur me caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurin M.A, ka vlerësuar rrethanat për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 73 të KPRK-ës, e si rrethanë rënduese, gjykata ka vlerësuar intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur, duke marrë parasysh faktin se pasojat e kësaj vepre penale kanë rezultuar me vdekjen e të dëmtuarit, ndërsa rrethanë tjetër rënduese nuk ka gjetur.

Ndërsa si rrethanë lehtësuese, ka vlerësuar sjelljen e tij para dhe pas kryerjes së veprës penale, pasi që ka qenë hera e parë që ka ra ndesh me ligjin, kohën e kaluar nga kryerja e veprës penale, pasi që kanë kaluar pothuajse nëntë vite, faktin se veprën penale e ka kryer nga pakujdesia, ka japur ndihëm palës së dëmtuar deri në momentin e fundit të jetës së tij, kështu duke u munduar të minimizoj pasojat e veprës penale, keqardhjen e shfaqur për rastin e ndodhur, gjykata ka marrë parasysh edhe moshën e tij, pasi që i njëjti është i moshës së shtyrë. Ndërsa, si rrethanë posaçërisht lehtësuese për të pandehurin është vlerësuar pranimi i fajësisë në tërësi për veprën penale që në hapje të shqyrtimit fillestar të çështjes.

Gjykata, në kuptim të nenit 75 të KPRK-së ka aplikuar dispozitat e zbutjes së dënimit, duke u bazuar në faktin se i pandehuri e ka pranuar fajësinë dhe se pranimi i fajësisë është rrethanë ligjore, në kuptim të nenin 71 par.1, nën-par.1.3 të KPRK-së, që gjykata të shqiptojë dënim nën minimumin e dënimit të paraparë për këtë vepër. Megjithatë, me rastin e zbutjes së dënimit, janë respektuar kufijtë e zbutjes sipas nenit 72 par.1, nën-par. 1.5 të KPRK-së, që në rastet e tilla, kur minimumi i dënimit për veprën penale është 1 vjet, dënimi mund të zbutet deri në tre (3) muaj. Duke marrë parasysh të gjitha këto rrethana si dhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, gjykata vlerëson se, shqiptimi i dënimit të kushtëzuar, ndaj të pandehurit është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurin. Po ashtu, gjykata vlerëson se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 41 par.1 të KPRK-së, që t'i parandaloj kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, si dhe të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale si dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Shpenzimet procedurale:

Vendimin për shpenzimet e procedurës gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449 të KPP-së, që kanë të bëjnë me shpenzimet e procedurës dhe ato për paushall gjyqësor. Ndërsa taksa për kompensimin viktimave të krimit, në kuptim të nenit 39 par. 3 të Ligjit nr. 05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Kërkesa pasurore juridike:

Sa i përket kërkesës pasurore juridike, gjykata ka vendosur si në pikën III të aktgjykimit, ashtu që në mbështetje të nenit 462 të KPP-së, palët e dëmtuar e udhëzoi në kontest të rregullt juridiko – civil.

Andaj gjykata duke u bazuar në dispozitat ligjore të nenit 358, 364, 449, 462 të KPPK-ës nga arsyeje e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

Departamenti i Përgjithshëm

P.nr.114/2018, datë 05.06.2024

Bashkëpunëtore Profesionale

Edita Koliqi

Gjyqtarja

Qëndresa Tahiri Islami

KËSHILË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta në ankesë në afat prej 30 (tridhjetë) ditë, nga dita e pranimit të aktgjykimit me shkrim. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate në kopje të mjaftueshme për gjykatën dhe palët.